



Buletini Mjedisor

KRJOHET AGJENSIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA



Qeveria ka miratuar në muajin Shkurt, Vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Qeveria Shqiptare e ka parë si shumë të nevojshëm ngritjen e kësaj agjencie, e cila do të kontribuojë në ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës e biodiversitetit, nëpërmjet menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura me interes kombëtar e ndërkombëtar. Po ashtu kjo strukturë e re do të kontribuojë në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit, edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimin të publikut për zonat e mbrojtura dhe mbështetjes së aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda këtyre zonave. Ajo do ta ketë selinë në Tiranë dhe do të varet nga ministri i Mjedisit. Sa i përket financimit të saj në vendim thuhet: "AKZM-ja është institucion buxhetor, që financo-

het nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Buxheti i AKZM-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura. AKZM-ja siguron të ardhura edhe nga shërbimet e kryera prej saj ndaj palëve të tjera. Tarifat e këtyre shërbimeve përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi. AKZM-ja administron të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe ato të siguruar nga donacionet dhe shërbimet ndaj palëve të tjera, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. AKZM-ja harton projektbuxhetin vjetor në bazë të projektprogramit vjetor të saj dhe ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të cilin ia përcjell ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura". Në mbledhjen e djeshme ekzekutivi ka përcaktuar

edhe detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni. Disa prej detyrave janë: "Të menaxhojnë rrjetin e zonave të mbrojtura, habitateve dhe llojeve natyrore e gjysmënatyrore me interes të ruajtjes, sipas ligjeve kombëtare dhe konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare. Promovojnë dhe mbështetnin grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit, edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin e publikut për zonat e mbrojtura.

Të mbështesë zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda zonave të mbrojtura". Krijimi i kësaj agjencie do të shërbejë edhe për hapjen e vendeve të punës, pasi do të ketë një staf prej 224 personash, nga të cilët 21 në zyrën qendrore dhe 203 në Administrata Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE NJË SFIDË QË KËRKON ZGJIDHJE



Vazhdon të jëtë një nga problematikat që kërkon vëmendje menaxhimi i integruar i

mbetjeve. Për të adresuar në mënyrën e duhur këtë problematikë, e cila ka shtrirje në disa Ministri, Kryeministri Rama, ka ngritur Komitetin Ndërmintor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, kryesuar nga zëvendës Ministri i Mjedisit, znj. Oljana Ifti.

Anëtarët përbërës të këtij Komiteti janë zëvendësministret e Ministrive të Linjës. Komiteti ka rreth 1 vit që mbledhet në mënyrë periodike.

Në mbledhjen e radhës të zhvilluar më 16 shkurt 2015 merrnin pjesë veç anëtarëve të nominuar, donatorë të huaj që operojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në këtë takim znj. Ifti bëri një prezantim të zhvillimeve të fundit në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Më pas znj. Ifti ja dha fjalën z. Mihallaq Qirjo, në cilësinë e përfaqësuesit të Grupit Këshillimor të krijuar nga ky Komitet.

Z. Qirjo prezantoi pikat kryesore, që duhet të jepen zgjidhje nga vendim-marrësit, të cilat janë:

1. Nevoja e standartizimit të menaxhimit të mbetjeve.

2. Riparja e Strategjisë së Menaxhimit të Mbetjeve.

3. Vendosja e banchmark për mbetjeve.
4. Gjetja e financimeve për të mundësuar një menaxhim të integruar të mbetjeve dhe pse jo që mund të jenë pjesë të Fondit Mjedisor.

5. Koordinimi me donatorët dhe biznesin në fushën e mbetjeve.

Më pas të pranishmit u njohën me disa gjetje nga projektete e Qeverisë Zviceriane për përcaktimin e indikatorëve për mundësimin e standartizimit të taksave në fushën e mbetjeve. Gjithashtu u prezantuan disa gjetje për menaxhimin e mbetjeve urbane nga autoriteteve lokale.

NË KËTË NUMËR:

KRJOHET AGJENSIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA	PQ.1
MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE NJË SFIDË QË KËRKON ZGJIDHJE	PQ.1
LETET MJEDISORE JANAR SHKURT 2015	PQ.2
KRJOHET FORUMI I PVJEVE TË BALLKANIT	PQ.3

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, dhe pyetje në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritit të vendit në Bashkimin Europian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilituar opinionin publik".

LEJET MJEDISORE JANAR SHKURT 2015

SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	LLOJI I LEJES
Euro Aditiv	Prodhimi i kimikateve organike bazë	Vorë km 16	Miratim	Tipi A
Zoto-ZZ	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Vlorë	Miratim	Tipi B
Zoto-ZZ (Lc-9275)	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Bashkia Himarë, Qarku Vlorë	Miratim	Tipi B
Aurora Line	Shkrirja dhe perfitimi i aliazeve te metaleve joferrose (me ngjyre) përfshirë produktet e rikuperuara	Tiranë	Miratim	Tipi B
San Leon Durrësi B.V	Kerkim i naftes dhe gazit natyror	Durrës	Miratim	Tipi A
Sarda-Grup	III.2.B Grumbullim, përpunim, riciklim dhe agsjesim i mbetjeve urbane, Lezhë spitalore, organike, kimike dhe bakteriologjike		Refuzim	Tipi B
G.I.B	Për përzierjen e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimin e betonit dhe blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Kukës	Miratim	Tipi B
Selami	Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo-metalike	Dibër	Miratim	Tipi B

SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	LLOJI I LEJES
Agbes Konstruksion	Për përzierjen e oimentos ose përdorimin e çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimin e betonit dhe blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos	Berat	Miratim	Tipi B
Shkemi	Miniere nëntokësore	Krastë,Dibër	Refuzim	Tipi B
Redi	Prodhim i mineraleve,rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Durrës	Miratim	Tipi B
Colacem Albania shpk	Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret	Lezhë	Miratim	Tipi B
Mimoza Uliu	Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike	Tiranë	Miratim	Tipi B
EHË	Trajtim dhe përpunim materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit)	Tiranë	Miratim	Tipi B
T-Zyka	III.2.B Transportim I mbetjeve te lengeta dhe te ngurta te ndotura me hidrokarbure te naftes bruto dhe lendet djegese	Fier	Refuzim	Tipi B

MINISTRIA E MJEDISIT KA NISUR PROJEKTIN PËR TRAJTIMIN E SËMUNDJES TË PYJEVE SHQIPTARE.



Pas premtimit të bërë nga Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, ditën e Shërbimit Pyjor Shqiptar (27 Janar 2015) filloi puna për të luftuar sëmundjen e procesionares, sëmundje që është shfaqur në drurët halorë të pyjeve shqiptare.

Menjëherë strukturat e Ministrisë së Mjedisit hartuan Programin Kombëtar për luftimin mekanik të procesionares, në katër rajone të vendit tonë që janë pyjet e zonës së Shkodrës, Dibër, Elbasanit dhe Korçës.

Faza e dytë, pas përcaktimit të zonave ku do të

ndërhyet, ishte trajnimi i strukturave, të cilët do të drejtojnë, monitorojnë dhe supervizojnë punën.

Ky trajnim u ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit u realizua nga Kordinatori Kombëtar, emëruar me urdhër të Kryeministrit si dhe nga tre kordinatorët rajonal. Gjithashtu kishte dhe përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe nga Agjensia Kombëtare të Mjedisit. Trajnuesit kishin si objektiv, përgatitjen e kordinatorëve rajonalë të emëruar nga Ministri i Mjedisit si dhe trajnimin e drejtuesve teknikë dhe supervizorëve të këtij operacioni.

Më pas këtë drejtues teknikë të trajnuar realizuan trajnime në praktikë me punonjësit e punësuar për zhdukjen e procesionares në terren.

Financimi i projektit është bërë i mundur nga Programi “Mbrotjtja e Mjedisit” miratuar për vitin


2015 për Ministrinë e Mjedisit, nëpërmjet VKM Nr. 104, datë 4.2.2015, të miratuar nga Kryeministri.

Në Programin Kombëtar është planifikuar ti nënshtrihen këtij operacioni 6335 ha pyje në grumbujt pyjor të pishës së zezë, në katër rajonet e sipërpërmendura dhe në projekt përfshihen 33 Njësi të Qeverisjes Vendore, Komuna dhe Bashki. Nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, do të punësohen mbi 6000 forca pune. Në zbatim të këtij programi kombëtar, për të garantuar zbatimin me sukses të tij: Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ministria e Mjedisit është iniciatore e këtij projekti dhe mbart peshën kryesore në zbatimin e tij.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS JANAR 2015

	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJE	VENDIMI
1	Decon	Kapanon industrial	Durrës	Vendim Paraparak
2	Gerta Konstruksion	Kapanon industrial	Shkozet, Durrës	Vendim Paraparak
3	AFRIMI K	VNM - TH/ Shfrytëzim mineral hekur - nikel	Arrëz, Kukës	Deklaratë Mjedisore
4	BAJRAMI N	VNM-P/Nyje fraksionimi dhe larje inertesh linjë prodhimi inertesh,	Xibrakë, Labbinot,	Vendim Paraparak
5	TIRANA BUSINESS PARK	VNM-P/Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura	Prezë, Tiranë	Vendim Paraparak
6	GENTJAN SALIU	VNM-P/Godinë 3-katëshe për prodhim dhe magazinim	Vaqarr, Tiranë	Vendim Paraparak
7	GLOBAL GAZ	VNM-P/Depozita sipërfaqësore të gazit natyror	Kashar, Tiranë	Vendim Paraparak
8	GARDEN BEER	VNM-P/Fabrikë prodhimi birre	Tiranë	Vendim Paraparak
9	RD - 2	VNM-P/Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrjes së torfes	Gurras, Korçë	Vendim Paraparak
10	KEA Host House	VNM-P/Shtëpia e të moshuarve Maminas	Durrës	Vendim Paraparak
11	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	VNM-P/Qëndër sportive "Tirana Olimpik Park"	Tiranë	Vendim Paraparak
12	MEC OIL & REFINING CO	VNM-P/impiant për trajtimin e mbetjeve të naftës	Saver, Lushnjë, Fier	Vendim Paraparak
13	CHROME INVEST	VNM TH / Fabrikë pasurimi kromi Tërnovë	Tërnovë, Dibër	Deklaratë Mjedisore
14	O.B KONSTRUKSION	VNM P shtes kapanoni	Durrës	Vendim Paraparak
15	JEDAS	VNM P godina banimi	Tiranë	Vendim Paraparak

KRIJOHET FORUMI I PYJEVE TË BALLKANIT



U nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis vendeve të Gadishullit Ballkanik, në fushën e sektorit pyjor, si një rajon gjeografik dhe historik i Evropës Juglindore me pasuri të mëdha natyrore dhe larmi të madhe biologjike. Memorandumi është shprehje e dëshirës së përbashkët për zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e pyjeve, duke e konsideruar shumë të rëndësishëm rolin e sektorit pyjor në zhvillimin ekonomik, në kontekstin e ndryshimeve dinamike të kushteve social-ekonomike në vendet palë, deri në sfidat e të ardhmes të ndikimit në ndryshimet klimatike në

nivel global.

Gjatë diskutimeve, mbas prezantimeve që pati çdo vend pjesëmarrës, në takimin e mbajtur në Sofje të Bullgarisë, u vu në pah rëndësia e zbatimit të Memorandumit nga palët nënshkruese, duke e konsideruar si një parakusht për gjetjen e rrugëve më të mira për arritjen e rezultateve efektive në ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në vendet e rajonit.


Memorandumi, do të shërbejë si një thirrje drejtuar të gjitha qeverive të vendeve pjesëmarrëse për kthimin në prioritet të politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe zhvillimin e sektorit pyjor.

Gjithashtu Memorandumi do të shërbejë jo vetëm për zhvillimin e dialogut të përbashkët, shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencës midis in-

stitucioneve përgjegjëse për administrimin e pyjeve të vendeve të rajonit, por edhe në ndërmarrjen e veprimtarive konkrete në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Për arritjen e objektivave në këtë drejtim, krijohet Forumi "Pyjet e Ballkanit", i cili do të garantojë komunikimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në këtë kuadër, midis palëve pjesëmarrëse. Forumi do të zhvillojë aktivitetin e tij në mbështetje të interesit të shoqërive dhe gjithë aktorëve të përfshirë nga sektori i pyjeve në Gadishullin e Ballkanit.


Pala shqiptare, e cila nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit, shprehu gadishmërinë për bashkëpunim dhe zbatim të tij, në funksion të bashkërendimit të politikave të pyjeve, zbatimin e tyre dhe raportimin në nivel rajonal dhe evropian.



SEKTORI I TRANSPARENÇËS DHE KOMUNIKIMIT

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE

TRAJNIM AUTORITETETVE LOKALE PËR RICIKLIMIN



Fermerë dhe specialistë të komunës Dajç morën pjesë në një trajnim tre ditor mbi bazat e kompostimit,

teknologjinë, materialet, pajisjet si dhe marketimin e tij për të arritur në një produkt me vlerë për të gjithë zonën. Ky trajnim zgjoi interes tek fermerët pavarësisht kohës së keqe dhe dëmeve të pësuar në vite. Fermerët gjatë trajnimit treguan interes dhe diskutuan me ekspertët mbi problemet që i shqetësojnë në lidhje me proceset e riciklimit dhe kompostimit si dhe vendosjen e disa standarteve për të shkëmbyer e unifikuar praktikatat e kompostimit



OSCE PËR PAKËSIMIN E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT



U zhvillua në Shqipëri takim i punës për forcimin e kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe Qendrave Aarhus në

Pakësimin e Rreziqeve nga Katastrofat (PRF) Këtë takim pune e organizonte prezenca e OSCE-së në Shqipëri në bashkëpunim me REC dhe UNDP. Ditën e parë të pranishmit në këtë takim vizituan zonën e Lezhës, e cila një vit më parë kishte përjetuar përmytjen në vitin e shkuar. Ditën e dytë takimi vijoi në Hotel Tirana, ku u prezantuan veç problematikave që hasen në Shqipëri u mundësua dhe dhënia e

eksperiencës çeke me raste të ngjashme si ajo Shqiptare. Takimin fillimisht e përshëndeti zëvendës Ambasadori i Prezencës së OSCE-së në Shqipëri z. Robert Eilton.

Në vazhdim të aktivitetit, të pranishmit u njohën nga z. Shemsi Prençi, Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile, Ministria e Punëve të Brendshme, me problematikat kryesore që haset kjo drejtori në përballjen me situatat e vështira natyrore që ndodhin në vendin tonë.

Në aktivitet ishte ftuar dhe z.Z. Pavel Cincera, ekspert ndërkombëtar i REC-ut, i cili i njohu të pranishmit me situatat e ngjashme në Republikën Çeke. Gjatë të gjithë ditës, autoritetet lokale të zonave që kanë pasur përballje me situata të vështira natyrore, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe Qendrave të Aarhusit u trajnuan se si mund të përfshihen për të ndihmuar për lehtësimin e këtyre situatave të emergjencave civile.



TRAJNIME PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE TË KONSULENTËVE MJEDISORË

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po organizon një seri workshopesh për ngritjen e kapaciteteve për konsulentët mjedisorë në Shqipëri, Maqedoni, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Mongoli, Serbi, Turqi dhe Ukrainë.

Në këtë kuadër, këtë javë po zhvillohet në

Tiranë, Shqipëri, workshopi një javor, me pjesëmarrjen e 20 përfaqësuesve të kompanive konsulente apo konsulentë në çështjet e mjedisit, të shëndetit, sociale dhe të sigurisë.

workshop kishte në fokus të tij: (i) politikat e BERZH për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë, dhe ato sociale, procedurat dhe kërkesat e kërkuara, përfshirë dhe monitorimin e projekteve, (ii) Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN) bankare dhe proceset investuese, sqarimin e dallimeve mes kërkesave mjedisore dhe sociale që lidhen me llojet e ndryshme të investimeve, (iii) mekanizmat ligjorë përmes të cilëve BERZH dhe të tjera institucione financiare bien dakort dhe ndërmarrin veprime që janë projektuar për të menaxhuar rrezikun dhe nxitur pajtueshmërinë me politikat e tyre përkatëse, (iv) çështjet specifike sektoriale me të cilat përballen klientët INF, dhe (v) aftësitë themelore të konsulentëve të BERZH, duke përfshirë dhe kërkesat kontraktuese të BERZH.

Përmes shkëmbimit të njohurive dhe përvojave të lehtësuesve dhe të pjesëmarrësve në ëorkshop, do të mund të qartësohen kërkesat dhe të identifikohen sfidat specifike për Shqipërinë.

